




**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

**Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural**  
**Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva i Ruralnog Razvoja**  
**Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development**

**Kabineti i Ministrit / Kabinet Ministra / Cabinet of the Minister**



**Datë: 11.03.2022**  
**Ref. KM-222/22**

Në mbështetje të nenit 145 (paragrafi 2) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke marrë parasysh nenet 8, 9, 10, 11 dhe 18 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/Nr.7/ 01 mars 2019), duke u bazuar në nenin 8 paragrafi 1 nën-paragrafi 1.4, nenin 15 Shtojcën 11 të Rregullores (QRK)-NR.02/2021 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (30.03.2021), Ministri i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, nxjerrë:

**V E N D I M**

1. Me këtë Vendim pezullohet përkohësisht Udhëzimi Administrativ MBPZHR NR. 07/2013 për Standardin për Pasurim të Miellit, Kontrollin e Sigurisë dhe Cilësisë së Pasurimit të Miellit, të datës 02 Gusht 2013.
2. Udhëzimi Administrativ nga pika 1 e këtij vendimi pezullohet deri me datën 31 korrik 2022.
3. Obligohet Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Faton Peci**  
**Ministër i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural**

*Vendimi i dërgohet:*

- *Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës,*
- *Kabinetit të Ministrit,*
- *Zyrës së Sekretarit Përgjithshëm, dhe*
- *Arkivit.*

